



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 120

14 shtator

2012

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 530, datë 7.8.2012	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës për universitetin “Fan S. Noli”, në Korçë, të pronës nr. 549, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	6803
Vendim i KM nr. 531, datë 7.8.2012	Për dhënien e lejes për hapjen e ciklit fillor në institucionin arsimor jopublik “Shkolla Franceze e Tiranës”.....	6805
Vendim i KM nr. 532, datë 7.8.2012	Për heqjen e licencës së kolegjit profesional privat “Luigj Benussi”.....	6805
Vendim i KM nr. 533, datë 7.8.2012	Për dhënien e lejes për hapjen e ciklit parashkollor në institucionin arsimor jopublik “Shkolla Franceze e Tiranës”	6806
Vendim i KM nr. 534, datë 7.8.2012	Për heqjen e licencës së kolegjit profesional privat “Dentarium-Al”	6806
Vendim i KM nr. 535, datë 7.8.2012	Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2012-2013	6807
Vendim i KM nr. 536, datë 7.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 827, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen, pranë universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) dhe për mënyrën e funksionimit të tij në periudhën kalimtare”	6813

Vendim i KM nr. 537, datë 7.8.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lumas, të qarkut të Beratit	6813
Vendim i KM nr. 538, datë 7.8.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Manëz të qarkut të Durrësit	6814
Vendim i KM nr. 539, datë 7.8.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gjergjan të qarkut të Elbasanit	6815
Vendim i KM nr. 541, datë 7.8.2012	Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të bashkia Kukës, të pronës nr. 437, me emërtim “Qendra e mobilizimit”, me vendndodhje në Kukës, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar	6816
Udhëzim i MPPT nr. 15, datë 23.8.2012	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 3606/2 (18), datë 28.10.2011 “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D dhe DE me certifikatën e aftësisë profesionale”	6827
Urdhër i MB nr. 230/2, datë 23.8.2012	Për revokimin e urdhrit nr. 230, datë 5.7.2012 “Për delegim kompetencash”	6832

VENDIM
Nr. 530, datë 7.8.2012

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS PËR UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”, NË KORÇË, TË PRONËS NR. 549, ME EMËRTIM “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “REPUBLIKA”, KORÇË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës për universitetin “Fan S. Noli”, në Korçë, të pronës nr. 549, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë për ta përdorur për mjedise pune për krijimin e kushteve për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe për garantimin e një infrastrukture të plotë e funksionale, në plotësim të nevojave të universitetit.

2. Prona nr. 549, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika” Korçë, hiqet nga lista e inventarit të pronave paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Dorëzimi i mjediseve të pronës nr. 549, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, Korçë, të bëhet pas ridislokimit në një destinacion tjetër të strukturave ushtarake të vendosura në këtë godinë dhe pas mbylljes nga Shtëpia Qendrore e Forcave të Armatosura, Tiranë, të veprimtarisë ekonomiko-financiare të këtij filiali, përfshirë heqjen e materialeve dhe të pajisjeve të magazinuara në këtë pronë.

4. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës e universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose ta japin në përdorim te të tretët.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE Të PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Ministria e Mbrojtjes Bashkia Korçë Fusha e Përdorimit të Pronës: Për Mbrojtjen										
	A			B			C			
Nr.	Zona kadastrale indeksi i hartës	Numri i pasurisë	Lloji i pronës	Emërtimi i pronës, adresa	Sipërfaqja totale e pronës në m ²	Nga sipërfaqja totale, sa ndërtime në m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
549				Shtëpia e Ushtarakëve	800 m ²	529 m ²	Për trajtimin e ushtarakëve	MM SH.Q.U, Tiranë	Shtëpia e Ushtarakëve, Korçë	-
				Bulevardi “Republika” Korçë						
				Hotel, bar, restorant	529	529				5 kate
				Truall	271	-				

VENDIM
Nr. 531, datë 7.8.2012

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E CIKLIT FILLOR NË INSTITUCIONIN
ARSIMOR JOPUBLIK “SHKOLLA FRANCEZE E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të ciklit fillor në institucionin arsimor jopublik “Shkolla Franceze e Tiranës”, që do të përfshijë në programin mësimor edhe lëndë në gjuhë të huaj.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për ndjekjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 532, datë 7.8.2012

PËR HEQJEN E LICENCËS SË KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT “LUIGJ BENUSSI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 44 pika 8 e 45 pika 4 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen e licencës kolegjit profesional privat “Luigj Benussi”, dhe të lejeve për hapjen e programeve të studimeve, në zbatim të saj.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 533, datë 7.8.2012

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E CIKLIT PARASHKOLLOR NË INSTITUCIONIN ARSIMOR JOPUBLIK “SHKOLLA FRANCEZE E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të ciklit parashkollor (kopsht), në institucionin arsimor jopublik “Shkolla franceze e Tiranës”, që do të zhvillojë mësimin edhe në gjuhë të huaj.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për ndjekjen e zbatimit të dispozitave ligjore e nënligjore për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 534, datë 7.8.2012

PËR HEQJEN E LICENCËS SË KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT “DENTARIUM-AL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 44 pika 8 e 45 pika 4 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen e licencës kolegjit profesional privat “Dentarium-AL” dhe të lejeve për hapjen e programeve të studimeve, në zbatim të saj.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 535, datë 7.8.2012

**PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË
PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË
DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2012-2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr. 104/1992 “Ligji kuadër për asistencën, integrimin social dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2012-2013, të jenë 10 045, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme | 9165; |
| b) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë | 40; |
| c) Kuotat për transferim studimesh | 200; |
| ç) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit | 400; |
| d) Kuota për personat që nuk shikojnë | 20; |
| e) Kuota për romët/ballkano-egjiptianë | 20; |
| ë) Kuota për të përndjekurit politikë | 150; |
| f) Kuota për shtetasit e huaj | 50. |

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Kuotat e çdo programi studimi ndahen në raportin 7:3, përkatësisht 70 % të tyre, për pranimet e reja, për programe të para studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe 30 % për pranimet e reja për programe të dyta studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme.

3. Kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuotat e përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, për kandidatët shqiptarë nga Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, pasqyrohen në tabelën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.



Kandidatët nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi dhe nga Prefektura e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Rishpërndarja e kuotave të paplotësuara kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke marrë parasysh edhe kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

5. Kuotat e pranimeve për personat që nuk shikojnë ndahen, për kandidatët me statusin për personat që nuk shikojnë, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

6. Kuotat e pranimeve për romët dhe ballkano-egjiptianët ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e Romëve dhe Shoqata Kombëtare e Ballkano-Egjiptianëve, të vërtetuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Kuotat e pranimeve për të përndjekurit politikë ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë dhe plotësimit të kriterëve të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë.

8. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, të përcaktuara në shkronjën “f” të pikës 1 të këtij vendimi, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nga personat e interesuar.

9. Çdo shtetas shqiptar, i cili ka përfunduar shkollën e mesme dhe zotëron diplomë të Maturës Shtetërore, dëftesë pjekurie apo çdo diplomë tjetër studimi, të fituar brenda ose jashtë vendit, të barasvlershme me të, ka të drejtë të aplikojë për në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe edukimit në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë. Kandidatët që zotërojnë dëftesë pjekurie apo diplomë të fituar brenda ose jashtë vendit, të barasvlershme me të, duhet të kenë fituar provimet me zgjedhje dhe të paraqesin në aplikim certifikatën përkatëse të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve.

10. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës, të përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara e të bëra publike paraprakisht.

11. Kandidatët që dëshirojnë të ndjekin studimet me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, brenda kuotës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, e fitojnë këtë të drejtë, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë e të bëra publike paraprakisht.

12. Tarifat e shkollimit për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2012-2013, të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES (TABELA Nr.1)

KUOTAT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIT NË DISTANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2012 - 2013

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	EMERTIMI I FAKULTETIT	ID_PR OGRA MIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat për studentët brenda vendit
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	1	Histori	250
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	2	Gjeografi	250
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	3	Gjuhë-Letërsi	250
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	4	Biologji	200
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	5	Punë Sociale	100
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	6	Psikologji	120
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	7	Sociologji	90
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	8	Drejtësi	300
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	9	Infermieri e Përgjithshme	100
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	10	Mami	20
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	11	Teknik i Lartë Laboratori	40
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	12	Fizioterapi	25
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	13	Imazheri	40
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	14	Administrim -Biznes	300
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	15	Financë-Kontabilitet	300
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	16	Prodhim Bimor	120
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	17	Inxhinieri Agrare - Agromekanizim	80
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	18	Zootekniki dhe Biznes Blegtoral	70
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	19	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	80
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	20	Hortikulturë	140
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	21	Mbrojtje Bimësh	140
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	22	Agromjedis dhe Ekologji	140
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	23	Menaxhim Agrobiznesi	120
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	24	Ekonomi dhe Politikë Agrare	100
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	25	Financë-Kontabilitet	120
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	26	Teknologji Agroushqimore	70
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	27	Vreshtari-Enologji	70
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Pyjore	28	Mbarështrim Pyjesh	70
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Pyjore	29	Përpunim Druri	70
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	30	Inxhinieri Logjistike Prodhimi (Program i Edukimit në Distancë)	40
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	31	Gjuhë-Letërsi	80
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	32	Cikël i Ulët	60
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	33	Cikël i Ulët Parashkollor	40
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Ekonomik	34	Financë-Kontabilitet	90
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Ekonomik	35	Menaxhim	90
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Ekonomik	36	Marketing	90
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Ekonomik	37	Turizëm	90
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Ekonomik	38	Turizëm (Filiali Pogradec)	50
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Bujqësisë	39	Agroushqim	60
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Bujqësisë	40	Agrobiznes	60
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Bujqësisë	41	Hortikulturë	50
Univ. "Fan Noli" Korçë	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane	42	Infermieri e Përgjithshme	90
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	43	Matematikë-Fizikë	90
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	44	Biologji-Kimi	90
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	45	Teknologji Informacioni	90
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Infermierisë	46	Infermieri e Përgjithshme	130
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Ekonomik	47	Administrim -Biznes	100
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Ekonomik	48	Financë-Kontabilitet	100
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Ekonomik	49	Ekonomia dhe e Drejta	100
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	50	Arsimi Fillor	100
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	51	Arsimi Parashkollor	80



Univ "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	52	Edukim Qytetar	80
Univ "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	53	Punonjës Social	80
Univ "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	54	Filozofi-Sociologji	80
Univ "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave Humane	55	Gjuhë-Letërsi	80
Univ "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave Humane	56	Histori-Gjeografi	80
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	57	Matematikë-Fizikë	100
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	58	Biologji-Kimi	100
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	59	Histori-Gjeografi	110
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	60	Gjuhë-Letërsi Shqipe	110
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	61	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	100
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	62	Mësuesi për Arsimin Fillor	100
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	63	Kontabilitet-Financë	100
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	64	Administrim Publik	100
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	65	Turizëm	100
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Natyrore	66	Fizikë	60
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Natyrore	67	Biologji-Kimi	60
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	68	Gjuhë-Letërsi	90
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	69	Histori	90
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	70	Gjeografi	90
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	71	Cikël i Ulet	120
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	72	Cikël i Ulet Parashkollor	90
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Ekonomisë	73	Financë-Kontabilitet	100
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Ekonomisë	74	Administrim -Biznes	100
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Ekonomisë	75	Turizëm	100
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Drejtësisë	76	Juridik	120
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Biznesit	77	Administrim Biznesi	190
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Biznesit	78	Financë-Kontabilitet	190
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Edukimit	79	Cikël i Ulet	60
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Edukimit	80	Psikologji-Sociologji	60
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Studimeve Profesionale	81	Infermieri e Përgjithshme	100
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike	82	Juridik	100
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Filiali i Peshkopisë	83	Cikël i Ulet	100
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Filiali i Peshkopisë	84	Financë-Kontabilitet	100
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	85	Shkenat e Lëvizjes	60
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	86	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	60
Univ."Ismail Qemali" Vlorë	Fakulteti i Ekonomisë	87	Administrim Biznesi	100
Univ."Ismail Qemali" Vlorë	Fakulteti i Ekonomisë	88	Menaxhim Turizmi	100
Univ."Ismail Qemali" Vlorë	Fakulteti i Shkencave Humane	89	Drejtësi	100
			TOTALI	9205

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES (TABELA Nr.2)

KUOTAT PER TROJET NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIT NË DISTANCË,
PËR VITIN AKADEMIK 2012 - 2013

EMERTIMI/UNIVERSITETI	EMERTIMI/FAKULTETI	ID_PR OGRA MIT	EMERTIMI/PROGRAMI	Kuotat per studentet nga Kosova	Kuotat per studentet Shqiptarë nga Mali i Zi	Kuotat per studentet Shqiptarë nga Maqedonia	Kuotat per studentet Shqiptarë nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja	Kuotat Totale Kosova + Trojet
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	1	Histori	5	5	5	5	20
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	2	Gjeografi	5	5	5	5	20
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	3	Gjuhë-Letërsi	5	5	5	5	20
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	4	Biologji	5	5	5	5	20
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	5	Punë Sociale	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Sociale	6	Psikologji	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	7	Sociologji	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Drejtësisë	8	Drejtesi	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	9	Infermieri e Përgjithshme	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	10	Mami	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	11	Teknik i Lartë Laboratori	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	12	Fizioterapi	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Infermierisë	13	Imazheri	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	14	Administrim -Biznes	2	2	2	2	8
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë	15	Financë-Kontabilitet	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	16	Prodhim Bimor	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	17	Inxhinieri Agrare - Agromekanizim	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	18	Zootehni dhe Biznes Blegjorale	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	19	Akukulturë dhe Menaxhim Peshkimi	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	20	Hortikulturë	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	21	Mbrojtje Bimësh	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	22	Agromjedis dhe Ekologji	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	23	Menaxhim Agrobiznesi	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	24	Ekonomi dhe Politike Agrare	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	25	Financë-Kontabilitet	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	26	Teknologji Agroushqimore	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	27	Vreshtari-Enologji	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Pjore	28	Mbarëshim Pjesh	2	2	2	2	8
Univ. Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Shkencave Pjore	29	Përpunim Druri	2	2	2	2	8
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	30	Inxhinieri Logjistike Prodhimi	2	2	2	2	8
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Shkencave Natyrore	66	Fizikë	2	2	0	0	4



Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Shkencave Natyrore	67	Biologji-Kimi	2	2	0	0	4
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	68	Gjuhë-Letërsi	2	2	0	0	4
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	69	Histori	2	2	0	0	4
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	70	Gjeografi	2	2	0	0	4
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	71	Cikel i Ulet	2	2	0	0	4
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	72	Cikel i Ulet Parashkollor	2	2	0	0	4
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Ekonomisë	73	Finance-Kontabilitet	2	2	0	0	4
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Ekonomisë	74	Administrim -Biznes	2	2	0	0	4
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Ekonomisë	75	Turizëm	2	2	0	0	4
Univ "L. Gurakuqi" Shkoder	Fakulteti i Drejtësisë	76	Juridik	2	2	0	0	4
Univ "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Biznesit	77	Administrim Biznesi	2	2	2	2	8
Univ "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Biznesit	78	Finance-Kontabilitet	2	2	2	2	8
Univ "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Edukimit	79	Cikel i Ulet	2	2	2	2	8
Univ "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Edukimit	80	Psikologji-Sociologji	2	2	2	2	8
Univ "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Studimeve Profesionale	81	Infermieri e Pergjithshme	2	2	2	2	8
Univ "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike	82	Juridik	2	2	2	2	8
Univ "A. Moisiu" Durrës	Filiali i Peshkopisë	83	Cikel i Ulet	0	0	3	3	6
Univ "A. Moisiu" Durrës	Filiali i Peshkopisë	84	Finance-Kontabilitet	0	0	3	3	6
Univ. i Sporteve Tirane	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	85	Shkencat e Lëvizjes	1	1	1	1	4
Univ. i Sporteve Tirane	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	86	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	1	1	1	1	4
			TOTALI	108	108	92	92	400

VENDIM
Nr. 536, datë 7.8.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 827, DATË 11.6.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN, PRANË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”,
DURRËS, TË FAKULTETIT TË STUDIMEVE TË INTEGRUARA ME PRAKTIKËN
(FASTIP) DHE PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË TIJ NË PERIUdhËN KALIMTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 9, 41 e 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2 të vendimit nr. 827, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave, afati nga “... 4 vjet (2008-2012), ...” bëhet “... 6 vjet (2008 -2014), ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 537, datë 7.8.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS LUMAS, TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Lumas, të qarkut të Beratit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1132 (një mijë e njëqind e tridhjetë e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Lumas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

6813



Komuna Lumas		Lidhje nr. 1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
289-302, 1124-1125	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
303-307	Prona që përdoren për realizimin e programeve shëndetësore	Në pronësi
308-327	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
328-359	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
360	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e kulturës	Në pronësi
361-362	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
363-402	Varrezat publike	Në pronësi
403	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën administrative.	Në pronësi
495-537	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
538-558	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
559-1061	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
1126-1127	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
1-17, 19-70, 72-90, 105-106, 109-111, 115-118, 121-127, 129-206, 209-267, 269-274, 276-286, 288	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e pyjeve dhe kullotave	Në pronësi te prona me nr. 200, transferohet vetëm 19.25 ha

VENDIM
Nr. 538, datë 7.8.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË MANËZ, TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Manëz, të qarkut të Durrësit, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Manëz, të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr. 470, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Manëz, të qarkut të Durrësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Manëz për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Manëz Durrës

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14-15	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore dhe sportive	Në pronësi
16-23	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
24-47	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
48-53	Prona që përdoren për shërbim funeral	Në pronësi
141,150,151,168, 177,191,192, 206, 209, 211, 216, 219, 221, 226, 229	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
207, 208, 210, 213, 214, 215, 220, 222, 223, 224, 225, 227, 228, 230, 231	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
232-269, 277-285	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 539, datë 7.8.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS GJERGJAN, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Gjergjan të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



Lista me 108 (njëqind e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 796 (shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gjergjan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Gjergjan

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
13, 14, 59-87	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet objekteve ose ndërtesave të çdo lloji	Në përdorim
15-58	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
88-102	Prona që përdoren për shërbime funerale	Në pronësi
103-653	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
662,669, 670, 697, 698, 699, 700, 704, 705, 706, 710, 711, 712, 716, 717, 718, 722, 723, 724, 729, 732, 733	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
702, 708, 709, 714, 715, 720, 726, 727, 730, 731, 734	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
701, 703, 707, 713, 719, 721, 725, 728	Pyje dhe kullota komunale	Në pronësi

VENDIM

Nr. 541, datë 7.8.2012

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË BASHKIA KUKËS, TË PRONËS NR. 437, ME EMËRTIM “QENDRA E MOBILIZIMIT”, ME VENDNDODHJE NË KUKËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të bashkia Kukës, të pronës nr. 437, me emërtim “Qendra e mobilizimit”, me vendndodhje në Kukës, sipas formularit tip të inventarizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për çerdhe dhe kopsht, për plotësimin e nevojave të komunitetit të bashkisë Kukës.

2. Prona nr. 437, me emërtim “Qendra e mobilizimit”, Kukës, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Bashkisë Kukës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr. 437, me emërtim “Qendra e mobilizimit”, në Kukës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, kryetari i bashkisë Kukës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha




RRETHI KUKËS

**3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave si klasa te vecanta)**


Bashkia Kukës										
A			B			C				
Nr	Zona Kadast. Indeksi i hartës	Numeri pasuris	Emertesa e pronës Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te pronës	Adresa/ vendodhja e komponenteve perberes	Permasat e Pronës ne M2 ose MI	Funksioni per te cilin perdoret prona	Enti me Pergjegjesi Administrative	Enti Perdorues Statusi Juridik i perdorimit	Te dhena te tjera shenime te veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
437			Qendra Mobilizimit			575 M2	Për Mbrotjtjen	MM Q. Mobilizimi Kukës	Qendra Mobilizim Kukës	
			Kukës	Godina e QM	Kukës	198				2 kate
				Fjetine	"	35				
				Truall	"	342				

PLANIMETRIA E ORE
DEGA USHTIA
SIF. : 143.75
SHKALLA 1:1





Nr 1 KATI PËRDIH E KUKËS




REP. E SHQIPËRISE MIN. E MBRËNJES E LGJIT	PROJEKTOR	DR. M. M. M. M. M.
	VERIFIKANT	DR. M. M. M. M. M.
TRASH. INST. E KUKËS	PROJEKTOR	DR. M. M. M. M. M.
DE	PROJEKTOR	DR. M. M. M. M. M.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
RRETHI KUKES

VERTETIM
NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR



Vërtetohet se në regjistrin hipotekor me nr. Vol-19 FR. 101 datë 21/04/2004 figuron e regjistruar në pronësi të:

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa
	<u>SHTETI</u>		<u>INDIVIDUALE (1)</u>
<u>(PASURIA ESHTË ME ADMINISTRIM TE MINISTRSE</u>			
<u>MBROTJES QENDRA E REKRUTIM MOBILIZIMIT</u>			
<u>KUKES)</u>			

Pasuria me numër 39/155 e ndodhur në Zonën Kadastrale 2315 me sipërfaqe 342 m², në adresën LAGJE NR. 6 KUKES
INDEKSI HARTES KU-J-6

Kufizimet e pasurisë janë:

V PASURIA NR. 39/154, 39/199, 39/195 L PASURIA NR. 39/199
J PASURIA NR. 39/153, 39/165 P PASURIA NR. 39/156

Origjina e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme: DOKUMENTI NR. 5830

nr. Hip. <u>/</u> , datë: <u>/ /</u>	nr. Hip. <u>/</u> , datë: <u>/ /</u>
nr. Hip. <u>/</u> , datë: <u>/ /</u>	nr. Hip. <u>/</u> , datë: <u>/ /</u>
nr. Hip. <u>/</u> , datë: <u>/ /</u>	nr. Hip. <u>/</u> , datë: <u>/ /</u>

Barrë mbi pasurinë: NUK KA

Komente nga Regjistruesi: PASURIA ESHTË ME EMERTIM
TRUALL (DOBORR)

Ky vërtetim është i vlefshëm i shoqëruar me Hartë Treguese të Regjistrimit Provizore.

Ky formular miratohet për vërtetimin
e pronësisë deri në përfundimin e
Regjistrimit Fillestar sipas
Ligjit Nr.7843, datë 13/07/1994.

Vërtetimi i pronësisë lëshohet sipas
kërkesës Nr. 4544
datë 22/04/2004 paraqitur në ZRPP.



Datë: 22/04/2004

REGJISTRUESI
Ramazan Tota
2040

Miruar nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUJES

Vol. 19, Fq. 16

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 2315 NR. 183/155

Indeksi i Hartës: KU-J-6

Adresa e pasurisë: Rrethi - KUKES KUKES KUKES

Nr. 6

Vijon në: Vol. Fq.

Vijon nga: Vol. Fq.

ZYRA E RREGJISTRIMIT

QENDRA E PUBLIKIMEVE ZYRTARE

PRISHTINE

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL

Brenda V.K.N. : Jo --> Ref: PLRREGJISTRIM

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë
1. 342 m ²	1. 342 m ²	1. m ²
Ref 05830	Ref 05830	Ref 05830
2. m ²	2. m ²	2. m ²
Ref	Ref	Ref
3. m ²	3. m ²	3. m ²
Ref	Ref	Ref
4. m ²	4. m ²	4. m ²
Ref	Ref	Ref

Për pjesën e

PALLI

Kuota e

Nr. i Pasurisë

Vol.

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Regjistrimit	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Nr. i Sh. Pronës	Shënime	Firma
05830	21.04.2004	SHTETI						

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkepronar (%)


SHTYPUR NË SHITËPSHKRONJEN "MORAVA", I APRIL, TIRANË, TIF. 272-02



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJSHME KUKES REGJISTRUESI <i>Ing. Ramazan Tota</i>	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE <u>23/5</u> NR. I PASURISE <u>39/55</u> Vol. <u>19</u> fq. <u>101</u> INDEKSI HARIES <u>K4-J-6</u> SHKALLA <u>1:500</u> ADRESA E PASURISE: Rrethi <u>KUKES</u> QJ <u>KUKES</u> VIL <u>6</u> PG Sh K Ap
	B. KUFIZIMET V <u>39/154, 39/199, 39/195</u> L <u>39/199</u> J <u>39/153, 39/165</u> P <u>39/156</u> D. Data: <u>22.06.2004</u> , Ora
	C. PRONARJET <u>SHTETI</u> ZYRA E REGJISTRIMIT PASURIVETE PALUAJTESHME KUKES PROVIZORE




PLAN RILEVIMI

PERGATITI: Emri: <u>BASHKIM ALLARAJ</u> Licensa Nr: <u>TZ 0449</u> Date: <u>15/08/2003</u> Data e Pergatitjes: <u>/ /</u> Bashkim Allaraj Topograf Nr Lic TZ 0449 <i>[Signature]</i> Vula/Firma:	IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE <u>2315</u> NR. I PASURISE _____ VOL. _____ FQ. _____ INDEKSI I HARTES <u>KU-3-G</u> SHKALLA <u>1:500</u> ADRESA E PASURISE: Rrethi <u>KUKËS</u> Q/F <u>KUKËS</u> B/L <u>NR. 6</u> P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____ PRONARI <u>Q.R.M. KUKËS</u>
---	---

SIP. NDËRTIMOR $233 m^2$

SIP. GJITHSEJ TRUALL $575 m^2$



QENDRA E MOBILIZIMIT SIP. = $198 m^2$

TRUPROJA SIP. = $35 m^2$


QBORRI SIP. = $5 m^2$

SIP E PËRGJITHSIAE $575 m^2$

Pronari (firma): Q.R.M. KUKËS



PLANI VENDOSJES Sh : 1 : 500
Objekti : Qendra e Mobilizimit Kukës
Adresa : Lagje nr. 6 Kukës



ZONA KADASTRALE 2315
INDEKSI HARTES KU - J - 6

QENDRA E MOBILIZIMIT	=	198 m ²
TRUPROJE	=	35 m ²
OBORRI	=	342 m ²
SIPERFAQJA E PERGJITHSHME	=	575 m ²

Shenime :

- ① QENDRA E MOBILIZIMIT
- ② TRUPROJE
- ③ OBORRI
- ④ RRETHIMI

P/SEKSIONIT URBANISTIKES

Ing. Emer. LLUKOVI.

Punoi : Ing. Muhamet DALACI

UDHËZIM
Nr. 15, datë 23.8.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 3606/2 (18), DATË 28.10.2011 “PËR
PAJISJEN E PËRDORUESVE TË MJETEVE RRUGORE TË KATEGORIVE C, CE, D DHE
DE ME CERTIFIKATËN E AFTËSIMIT PROFESIONAL”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të pikave 8 dhe 9 të nenit 115, të nenit 224 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 294, 295, 296 dhe 297 të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

- I. Në nenin 31 fjalia e parë ndryshon si vijon:
“Certifikata e Aftësisimit Profesional është sipas modeleve bashkëlidhur”.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR

AL

ÇERTIFIKATË E AFTËSISË PROFESIONALE (ÇAP)
Certificate of Professional Competence (CPC)

Nr. _____

TIPI / TYPE

KC	KC+E	KD	KD+E

Ser.NR.: _____

Shënim: Kjo çertifikatë është e vlefshme në përputhje me Direktivën e BE 2003/59/EC nëse shoqërohet me Lejen Kombëtare të Drejtimit.

Note: This certificate is valid in accordance with EU Directives 2003/59/EC if it is accompanied by the National Driver License.

Tipi KC, për drejtues të automjeteve të kategorisë C.
Type KC, for drivers of vehicles of category C.

Tipi KC+E, për drejtues të automjeteve të kategorisë CE.
Type KC+E, for drivers of vehicles of category CE.

Tipi KD, për drejtues të automjeteve të kategorisë D.
Type KD, for drivers of vehicles of category D.

Tipi KD+E, për drejtues të automjeteve të kategorisë DE.
Type KD+E, for drivers of vehicles of category DE.

- Çdo korrigjim e bën të pavlefshme këtë çertifikatë.

Çertifikata është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
Certificate is valid 5 years from date of issue.



Ser.NR.: _____

5. Nr.Leje Drejtimi _____
Driving Licence number

6. Lëshohet në bazë të vendimit të
Issued by decision of testing commission
komisionit të testimit

KC Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____

KC+E Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____

KD Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____

KD+E Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____

8. Data e lëshimit ____/____/____
Issue date

9. E vlefshme deri më ____/____/____
Valid until

10. Lëshohet nga **DPSHTRR**
Issued by DPSHTRR

Drejtori Rajonal
Regional Director

Foto

3.5 x 4.2

1. Emri: _____
Name:

2. Mbiemri: _____
Surname:

3. Atësia: _____
Father:

4. Datëlindja: _____
Date of birth:

5. Vendbanimi: _____
Place of birth:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR

AL

ÇERTIFIKATË E AFTËSISË PROFESIONALE (CAP)
Certificate of Professional Competence (CPC)

Nr. _____

TIPI / TYPE

KC	KC+E	KD	KD+E

Ser.NR.: _____

Shënim: Kjo çertifikatë është e vlefshme në përputhje me Direktivën e BE 2003/59/EC nëse shoqërohet me Lejen Kombëtare të Drejtimit.

Note: This certificate is valid in accordance with EU Directive 2003/59/EC if it is accompanied by the National Driver License.

Tipi KC, për drejtues të automjeteve të kategorisë C.
Type KC, for drivers of vehicles of category C.

Tipi KC+E, për drejtues të automjeteve të kategorisë CE.
Type KC+E, for drivers of vehicles of category CE.

Tipi KD, për drejtues të automjeteve të kategorisë D.
Type KD, for drivers of vehicles of category D.

Tipi KD+E, për drejtues të automjeteve të kategorisë DE.
Type KD+E, for drivers of vehicles of category DE.

- Çdo korrigjim e bën të pavlefshme këtë çertifikatë.

Çertifikata është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
Certificate is valid 5 years from date of issue.



Ser.NR.: _____

Foto 3.5 x 4.2	5. Nr. Leje Drejtimi _____ Driving Licence number
1. Emri: Name	6. Lëshohet në bazë të vendimit të komisionit të testimit Issued by decision of testing commission
2. Mbiemri: Surname	KC Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____
3. Atësia: Father	KC+E Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____
4. Datëlindja: Date of birth	KD Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____
5. Vendbanimi: Place of birth	KD+E Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____
	8. Data e lëshimit Issue date
	9. E vlefshme deri më Valid until
	10. Lëshohet nga DPSHTRR Issued by DPSHTRR
	Drejtori Rajonal Regional Director



URDHËR
Nr. 230/2, datë 23.8.2012

**PËR REVOKIMIN E URDHËRIT NR. 230, DATË 5.7.2012 “PËR DELEGIM
KOMPETENCASH”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 121 e në vijim, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Revokimin e urdhrit nr. 230, datë 5.7.2012 “Për delegim kompetencash”, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Ferdinand Poni, të trajtimit të korrespondencës për marrjen e mendimeve nga ministritë e linjës lidhur me projektvendimet e pronave që hartohen nga Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, në zbatim të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 13.9.2012
Doli nga shtypi më 14.9.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 38 lekë